MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE (SPOTET TELEVIZIVE)

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në **MTKRS** me objekt: "Mbi përdorimin e shpenzimeve buxhetore për spotet publicitare, ngjarje kulturore, artistike e sociale dhe festa e ngjarje të tjera solemne e protokollare me porosi të qeverisë, për periudhën 1/1/2007 deri me 31/12/2011 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 71, datë 16/05/2012.
Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 251/43, datë 16/05/2012 dërguar ***Z. Aldo Bumçi, Minister i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,*** krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1. Nga auditimi i kryer në MTKRS u konstatua se, në vendimet e KM nr. 1195, datë 5/8/2008 "Për blerjen, zhvillimin, prodhimin e bashkëprodhimin e programeve a të reklamave për transmetim nga operatorët radiotelevizivë ose botim në medien e shkruar, dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore" dhe nr. 1173, datë 6/11/2009 "Për përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale nga organet e qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike, të pavarura"; ka mangësi në përcaktimin e rregullave për mënyrën e llogaritjes së fondit të nevojshëm për kryerjen e aktivitetit
Për këtë, **rekomandojmë që,** të bëhen ndryshimet e nevojshme ligjore në pikat 6 dhe 11 të VKM nr. 1195, datë 5/8/2008 dhe pikës 2, kreu II, të VKM nr. 1173, datë 6/11/2009, *duke përcaktuar procedurën që do të ndiqet nga autoritetet kontraktore për mënyrën e llogaritjes së fondit të nevojshëm për blerjen, zhvillimin, prodhimin e bashkëprodhimin e programeve a të reklamave, me qëllim përcaktimin së më të drejtë të fondeve të nevojshme dhe kryerjen cilësore të shërbimeve të kërkuara.*
Gjithashtu, të përcaktohet qartë dokumentacioni që duhet të përgatisë komisioni i ngarkuar për zbatimin e procedurave në përzgjedhjen e operatorit të specializuar për kryerjen e aktivitetit.

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Në kontratat tip të nënshkruara nga palët (MTKRS dhe subjektet), janë konstatuar mjaft mangësi e parregullsi lidhur me kushtet për kryerjen e shërbimit, të drejtat e detyrimet e palëve, mënyrën e veprimit në rastet e mospërmbushjes së detyrimeve, penalitetet etj., pasi konceptimi i tyre nuk është bërë sipas kërkesave të përcaktuara në Ligjin nr. 7850, datë 29/7/1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.
Për këtë**, rekomandojmë që,** të merren masa që të përmirësohen e plotësohen kontratat e shërbimit me nenet e duhura, që të përcaktojnë në mënyrë të hollësishme të drejtat e detyrimet e palëve, sanksionet në rastet e mosplotësimit të objektit të kontratës dhe mënyrën e veprimit në kushtet e krijimit të mosmarrëveshjeve, duke ju referuar kushteve të përcaktuara në Ligjin nr. 7850, datë 29/7/1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.

Menjëherë

C. <u>MASA PËR SHPËRBLIM DËMI</u>

- *Mbështetur në nenin 608, të ligjit nr. 7850, datë 29/7/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" me ndryshimet e mëvonshme, të nxirren aktet administrative, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhen ndalesat,* si më poshtë:

1. MTKRS të marrë masa, duke ndjekur procedurat në rrugë ligjore për të kërkuar nga subjekti [redacted] arkëtimin **e shumës 102 mijë lekë,** që përfaqëson tatimin mbi të ardhurat që duhet të mbaheshin në burim për artistët pjesëmarrës në veprimtaritë artistiko-kulturore në kuadrin e 65 vjetorit të Festës Kombëtare të Çlirimit të Shqipërisë, organizuar në vitin 2009.

Korrik 2012

D. <u>MASA DISIPLINORE</u>

D.1 *Mbështetur në ligjin nr.7961, datë 12/7/21995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" me ndryshimet e mëvonshme, neni 37, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:*

"Zgjidhje e kontratës së punësimit ", neni 37, për:

1. [redacted] **Kryetar i grupit të monitorimit të kontratës** për transmetimin e spotit publicitar "Promovimi i turizmit në Shqipëri", nga kanali EURONEWS.
2. [redacted] **anëtar**
3. [redacted] **anetar**
- Për moszbatim të detyrave të ngarkuara për monitorimin e kontratës mbi transmetimin e spotit publicitar "Promovimi i turizmit në Shqipëri", nga kanali EURONEWS, duke shkaktuar një dëm ekonomik **në shumën 36,250 euro, ose**

4,456,937 lekë, e përvetësuar padrejtësisht nga Kontraktuesi, që përfaqëson vlerën e 12 spoteve publicitare të pa transmetuara.

E. <u>KALLËZIM PENAL</u>

Në vlerësimin e veprimtarisë së subjektit të audituar (MTKRS), janë evidentuar ***elementë të veprës penale, për këtë bëhet kallëzim penal,*** për:

1. [redacted] Kryetar i grupit të monitorimit të kontratës për transmetimin e spotit publicitar "Promovimi i turizmit në Shqipëri", nga kanali EURONEWS.

2. [redacted] anëtar

3. [redacted] anetar

- Personat direkt përgjegjës, për mos zbatim të detyrave dhe procedurave ligjore lidhur me monitorimin e kontratës me kanalin "EURONEWS" për transmetimin e spotit publicitar "Promovimi i turizmit në Shqipëri", duke shkaktuar **një dëm ekonomik në shumën 36,250 euro, ose 4,456,937 lekë,** e përvetësuar padrejtësisht nga Kontraktuesi, që përfaqëson vlerën e 12 spoteve publicitare të pa transmetuara.

<u>Shënim</u>: Auditimi u krye nga audituesit Bajram Lamaj Përgjegjës Grupi dhe Fadil Dekovi. Më tej u shqyrtua nga Kryeauditues i Departamentit zj. Luljeta Nano, Drejtori i Departamentit z. Ded Trieshi dhe Drejtore e Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë zj. Evana Tivari, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm z. Robert Gjini.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT